



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS KOSOVO DOCTORS CHAMBER LEKARSKA KOMORA KOSOVA			
Njësia: Unit:	K.S.N.E	Nr. Prot.: Prot. No.:	01/2018
Jedinita: Br. Prot.:		Date: Datum:	06.09.2018
Nr. i faqave: No. of pages:	02	Prishtinë/	
Br. stranicat:			

ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS  
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

NR. I REF. 01/2018

**KOMISIONI PËR SOLIDARITE DHE NDIHMË RECIPROKE**, në mbështetje të dispozitave të Nenin 35, paragrafit 1 me nën-paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësor, Nenit 46 dhe 47, paragrafit 1 me nënparagrafin 1.7 të Statutit të Odës së Mjekëve të Kosovës, Nenit 14 dhe 15 të Rregullores së Punës së Komisionit për Solidaritet dhe Ndhimë Reciproke, në mbledhjen e datës 29.08.2018, nxjerrë këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET kërkesa e anëtarës dr. \_\_\_\_\_ e punësuar pranë \_\_\_\_\_ për ndihmë financiare të njëhershme në lartësi prej 1,000.00 (njëmijë) € (Euro).
- II. URDHËROHET Shërbimi Profesional i OMK-së që të ekzekutojë shumën e miratuar financiare në llogarinë e parashtruesës së kërkesës nga paragrafi I i këtij vendimi, pas aprovimit për ekzekutim nga Kryetari i OMK-së. Shuma e tillë ekzekutohet në emër të ndihmës financiare për terapinë mjekësore për periudhën 3 (tre) mujore nga hyrja në fuqi të këtij vendimi.
- III. OBLIGOHET parashtruesja e kërkesës që për 3 (tre) muaj të ardhshëm të arsyetojë shpenzimin e mjeteve të dhuruara me deponimin e faturave pranë Shërbimit Profesional të OMK-së.
- IV. Mjetet financiare nga paragrafi I i këtij vendimi do të ezkeutohen në xhirrolloarinë e deklaruar personale të përfitueses së ndihmës financiare.

*Arsyetim*

Me datë 20.04.2018, anëtarja e OMK-së, dr. \_\_\_\_\_ ka parashtruar kërkesën me nr. të ref. 192/2018, me të cillën ka kërkuar mbulimin e shpenzimeve për terapinë mjekësore lidhur me sëmundjen nga e cila lëngon. Së bashku me kërkesën e parashtruar, e njëjta ka bashkëngjitur edhe dokumentacionin përcjellës me të cilin dëshmohet se vuan nga sëmundja sipas raportit mjekësor *leukemi chronice Myeloide*. Po ashtu e njëjta në bashkëngjitje të kërkesës ka sjellur rezultatet e analizave me të cilën dëshmohet natyra kronike e sëmundjes nga e cila lëngon.

Komisioni për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke, me datë 29.08.2018 ka mbajtur mbledhjen në të cilën ka shqyrtuar kërkesën e parashtrueses. Me këtë rast, Komisioni pas shqyrtimit të kërkesës me shkresat përcjellëse të lëndës ka konstatuar se parashtruesja e kërkesës vuan nga sëmundja e diagnostifikuar *leukemi chronice Myeloide* që kategorizohet si sëmundje e rëndë. Po ashtu gjatë vlerësimit të kërkesës Komisioni ka ardhur në përfundim se terapia adekuate dhe sipas udhëzimeve të mjekut të rastit përbën medikament që ka kosto të lartë dhe në bazë të standardit të përgjithshëm jetësor në Republikën e Kosovës, përbën shpenzim tejet vështirë të përballueshëm.

Komisioni gjatë vendosjes për çështjen ka konsideruar se ndihma e tillë financiare do t'ia lehtësojë mundësinë financiare parashtrueses që të sigurojë terapinë e nevojshme për kurimin e sëmundjes nga e cila lëngon. Sa i përket lartësisë së shumës për ndihmën financiare, Komisioni ka marrë për bazë çmimin mesatar të medikamentit të llojit Glivec 400 mg (1x1 tabletë në ditë) duke e llogaritur çmimin e tillë për shumë totale për nevojat tre mujore të medikamentit të tillë.


Andaj, Komisioni për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke, duke u mbështetur në dispozitat e Nenit 7, paragrafit 1 me nënparagrafin 2 të Rregullorës së Punës së Komisionit për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke, vendosi si në dispozitivin e këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit të tij nga Komisioni për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke.

Prishtinë, 29.08.2018

Kryetari i Komisionit për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke

DR. Xhevat Plana



**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të parashtrojë ankesë pranë Këshillit Drejtues të OMK-së në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të këtij vendimi.